

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“BRANDS MAISON” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 21.02.2024 në Tiranë,

Z.Rexhino Xhido shtetas shqiptar, i lindur më 29.03.1990 në Durrës, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.J00329076H.

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë **Brands Maison Shpk**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria **Brands Maison Shpk** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat .Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Brands Maison Shpk**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Tregti me shumice e veshjeve të brandeve të ndryshme, ndërmjetësim dhe konsulence.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rr."Sami Frasheri" Pallati Titan Konstruksion,Godina nr.8.9.20.11.12, Kati 2, Njesia Administrative Nr.10, zona Ish Ekspozita, Tirane , Shqipëri.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë



Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 10.000 (dhjetemije) lek, dhe është i ndarë në 1 kuote. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Z.Rexhino Xhido 1 kuotë, me vlerë 10.000 Lekë, zotëron 100%

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetëm i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë: **Z.Rexhino Xhido** shtetas shqiptar, i lindur më 29.03.1990 në Durres, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.J00329076H.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:


a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

NENI 9



Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES

REXHINO XHIDO
